



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:228087
Datë: 04.07.2022
Numri i dokumentit: 03394133

C.nr.1012/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari **Betim Behluli**, me bashkëpunëtoren profesionale **Adelina Çmega**, në çështjen juridike të paditësve Sh. Sh. nga Prizreni, N. B. nga fshati Drenoc, Komuna Rahovec, D. B. nga fshati Opterushë, Komuna Rahovec, dhe K. S. nga fshati Drenoc, Komuna Rahovec, të punësuar në SHFMU “Dëshmoret e Zatriqit” në Zatriq, të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i tyre i autorizuar avokati A. M. nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar avokat B. O. nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit **9, 980.10 €**, pas mbajtjes përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor, më **20.06.2022**, merr këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET padia dhe kërkesëpadia e paditësve Sh. Sh., N. B., D. B. dhe K. S., si dhe

DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që:

1. Paditëses së parë **Sh. Sh.** me fakultet katërvjeçar ti kompensoj 27% nga paga bazë (421,00 €), përkatësisht për çdo muaj nga 113, 67€, duke zbritur shumën prej 58,32€ që iu është paguar me kontratë dhe listën e pagave, pra të iu paguaj shumën e mbetur për çdo muaj nga 55,45 € për gjithsej 46 muaj, shumën e përgjithshme prej **2, 550. 70 €**.
2. Paditësit të dytë **N. B.** me fakultet katërvjeçar ti kompensoj 27% nga paga bazë (421,00 €), përkatësisht për çdo muaj nga 113, 67€, duke zbritur shumën prej 58,32€ që iu është paguar me kontratë dhe listën e pagave, pra të iu paguaj shumën e mbetur për çdo muaj nga 55,45 € për gjithsej 42 muaj, shumën e përgjithshme prej **2, 328. 00 €**.
3. Paditësit të tretë **D. B.** me fakultet katërvjeçar ti kompensoj 27% nga paga bazë (421,00 €), përkatësisht për çdo muaj nga 113, 67€, duke zbritur shumën prej 58,32€ që iu është paguar me kontratë dhe listën e pagave, pra të iu paguaj shumën e mbetur për çdo muaj nga 55,45 € për gjithsej 46 muaj, shumën e përgjithshme prej **2, 550. 70 €**.
4. Paditëses së katërt **K. S.** me fakultet katërvjeçar ti kompensoj 27% nga paga bazë (421,00 €), përkatësisht për çdo muaj nga 113, 67€, duke zbritur shumën prej 58,32€ që iu është paguar me kontratë dhe listën e pagave, pra të iu paguaj shumën e mbetur

për çdo muaj nga 55,45 € për gjithsej 44 muaj, shumën e përgjithshme prej 2, 550.70 €, apo në shumë të përgjithshme prej **9, 980.10 €**, të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur prej ditës së paraqitjes së padisë nga data (12.10.2021), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm, **SI ME BAZË**.

DETYROHET e paditura që në po të njëjtin afat, paditëses t'i paguaj edhe shpenzimet procedurale në shumë prej **619.00 €** me kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësit Sh. Sh., N. B., D. B. dhe K. S. nëpërmjet përfaqësuesit të tyre të autorizuar kësaj gjykate i kanë ushtruar padinë, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës.

E paditura me parashtrësën e saj përgjigje në padi, e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve ndaj të paditurës.

Sipas kësaj çështje juridike është caktuar seanca e shqyrtimit kryesor, në të cilën janë paraqitur përfaqësuesi i paditëses avokati A. M., si dhe përfaqësuesi i të paditurës avokat B. O..

Përfaqësuesi i autorizuar i paditëses avokati A. M. ka deklaruar: se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, të gjithë paditësit janë në marrëdhënie pune pranë të paditurës në institucionin arsimor në SHFMU “Dëshmoret e Zatriqit” në Zatriq. Paditësve pos të drejtave tjera duke u bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit të vitit 2017, iu takon kompensimi për licencim nga marrëdhënia e punës e që e paditura pjesërisht e ka kryer detyrimin e vet, çka vërtetohet në baze të listës se pagave të paditësve për çdo muaj u janë paguar pjesërisht pagesat, ndërsa për pjesën tjetër për secilin paditës nuk e ka përmbushur detyrimin nga kontrata kolektive. Paditësit për hir të ekonomizimit të procedurës me parashtrëse të veçantë me nr. prot. 1094, të datës 29.03.2022, iu janë drejtuar të paditurës që çështja të përfundojë në procedure administrative, mirëpo e paditura as sot e kësaj dite nuk i ka përmbushur detyrimet ndaj paditësve. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se edhe me tej ngel në tërësi pranë padisë së ushtruar, kërkesëpadisë pretendimeve në padi, si dhe pranë deklaratës së dhënë në seance, ku gjykata me prova formale-juridike pa kushte ka vërtetuar faktin se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura në kohë të pacaktuar, po ashtu gjykata ka vërtetuar faktin me rëndësi se këtu e paditura pjesërisht e ka përmbushur detyrimin e vet për secilin paditës kompensimin në emër të simulimit për kualifikim, mirëpo nuk ua ka kompensuar për çdo muaj shumën siç parashihet me Kontratën Kolektive të Arsimit Parauniversitar të vitit 2017. Kontestimet e të përfaqësuesit të të paditurës me përgjigje në padi nuk kanë asnjë efekt në ligjet që është thirrur e paditura, meqenëse në rastin konkret Kontrata Kolektive, si akt i veçantë i delegon të gjitha ligjet tjera, po ashtu thirrja e përfaqësuesit të të paditurës se kërkesëpadia e paditësve është parashkruar nuk qëndron, meqenëse afati rrjedh që nga data 18.04.2020, pra nuk kemi të bëjmë me parashkrim. Andaj i propozoi gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovojë në tërësi si të bazuar, si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës sipas tarifave të Odes së Avokateve të Kosovës.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës B. O. ka deklaruar se në tërësi e kontestojnë kërkesëpadinë dhe precizimin e kërkesëpadisë të paditëses si të pabazuar dhe të pathemeltë ndaj të paditurës komuna e Rahovecit, me arsyetimin se të paditurës i mungon legjitimiteti real pasiv duke marrë për bazë se kontrata kolektive është nënshkruar nga organi i nivelit qendror nga

MASHT dhe SBASHK, ndërsa e paditura nuk ka qenë nënshkruese e kësaj kontrate si nivel lokal, kjo në kuptim të nenit 90 paragrafi 2 i Ligjit të Punës, me të cilin është paraparë që kontrata kolektive mund të lidhet në tri nivele. E paditura mendon që paditësja duke marrë për bazë theksimet si më lart është dashur që kërkesëpadinë ta drejtoj edhe ndaj Ministrisë së Arsimit si nënshkruese të kontratës në fjalë. E paditura në parim nuk ka kundërshtuar dispozitat e Kontratës Kolektive të cilat kanë qëllim përmirësimin e kushteve për mësimdhënësit por që në bazë të dispozitave që kanë implikime financiare nuk ka mundësi buxhetore dhe për të zbatuar këto dispozita pasi që palët kontraktuese në këtë kontratë nuk kanë zbatuar nenin 46 të së njëjtës. Mbrojtja e të paditurës mbetet në qëndrimin si në përgjigje në padi, ngase kontrata kolektive është nënshkruar në mes të MASHT dhe SBASHK dhe ashtu siç konstaton edhe Gjykata Kushtetuese në rastin numër KO139/18 se kjo kontratë reflekton vullnetin reciprok në mes të dy palëve nënshkruese.

Sa i përket buxhetimit të mjeteve lidhur me kërkesëpadinë e paditëses e paditura në përgjigje në padi ka dhënë shpjegime të mjaftueshme për mënyrën e alokimit të buxhetit për nivelin lokal siç është e paditura këtu, theksojmë se në bazë të qarkoreve buxhetore të Ministrisë së Financave për vitin 2019, 2020 dhe 2021 në asnjë nga këto qarkore të cilat konsiderohen dokumente bazë për krijimin e buxhetit vjetor, nuk është paraparë respektivisht nuk është alokuar asnjë mjet financiar për kompensimin e ushqimit apo të udhëtimit. Për vitin 2019 komunës së Rahovecit i janë alokuar mjetet në shumën prej 22.967,00 Euro në emër të tri pagave përcjellëse, kjo në bazë të kalkulatorit sipas pikës 2.2 të kësaj qarkore. Në vitin 2020 komunës së Rahovecit i janë alokuar 46.643,00 Euro në emër të tri pagave përcjellëse të pensionimit, ndërsa për vitin 2021 në emër të tri pagave përcjellëse të pensionimit janë ndarë gjithsej 42.150,00 Euro dhe për herë të parë janë ndarë 27.169,00 Euro në emër të pagave jubilarë sipas kontratës kolektive andaj përtej kësaj që është paraparë në Ligjin për Buxhetin e RKS-së dhe ndarjes buxhetore, e paditura nuk ka kompetencë ligjore për të kryer pagesat tjera në emër të kompensimeve sipas kontratës kolektive të arsimit para universitar. Rrjedhimisht për të gjitha vitet sipas kërkesës për kompensimin e licencimit janë përtej mundësive ligjore për të kryer pagesa sipas kërkesëpadisë së paditësve.

Në aspekt procedural gjykata nuk ka vepruar në përputhje me nenin 67 dhe 68 të ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i propozojmë gjykatës që kësaj lënde të ia bashkojë edhe lëndë të tjera me paditës me bazë të njëjtë të padisë në emër të parimit të ekonomizimit të procedurës. E paditura mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi, në veçanti ritheksoj çështjen e periudhës kohore përtej datës 22.01.2021, për faktin se kontrata kolektive e viti 2017 është shfuqizuar, me këtë datë me nënshkrimin dhe hyrjen në fuqi të kontratës së re të Arsimit, pikërisht me datën 22.01.2021. Kontrata e Re ka përcaktuar rregulla tjera për pagesat e kompensimeve, e sipas të njëjtës nuk mund të kërkohet kompensim para vitit 2023, sepse për këtë periudhë i është dhënë mundësia palëve kontraktuese që ti kryejnë obligimet deri në fund të vitit 2023, andaj konsiderojmë që kërkesëpadia e paditëses përtej datës 22.01.2021, është e pabazuar. Gjithashtu deklaroi se KKAK në nenin 7 nuk ka përcaktuar se duhet të kompensohet mësimdhënësi me përqindjen sipas kërkesëpadisë po ashtu nëse ky kompensim duhet të bëhet nga punëdhënësi drejtpërdrejtë, andaj e paditura konsideron se nuk ka legjitimitet real pasiv në kuptim të dispozitës së nenit 7 të KKAK, për të qenë palë në këtë procedurë. Siç kemi theksuar edhe në përgjigjen në padi në bazë të nenit 87 të Ligjit të Punës të gjitha kërkesat monetare nga marrëdhënia e punës parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh. Paditësit kanë parashtruar padi në gjykatë me 5 prill 2022, andaj konsiderojmë se kërkesëpadia është parashkruar në bazë të kontratës të vitit 2017, ndërsa me kontratën e viti 2021 konsiderojmë se padia është e parakohshme sipas dispozitave të kësaj kontrate e cila përcakton afatin për pagesë vullnetare të implikimeve financiare deri në fund të viti 2023. Lidhur me objektin e shqyrtimit lëndor i propozojmë gjykatës që ti bashkoj subjektet paditëse në grupe sipas shkollave ngase me këtë hyjnë në zbatim parimi i ekonomizimit të procedurës si në sqarim në përgjigje në padi.

Për të vërtetuar faktet vendimtare në lidhje me këtë çështje kontestimore, gjykata i ka zbatuar provat duke bërë shikimin e tyre, për paditësen e parë Sh. Sh. ka bërë shikimin e vendimit për caktimin e ushtruesit te detyrës te drejtoritë shkollës të lëshuar nga kryetari i komunës të datës 31.12.2020, ka bërë shikimin në vërtetimin për përvojën e punës me nr. 225, të datës 19.07.2021, ka bërë shikimin në diplomën e fakultetit me nr. 190, të datës 23.02.2010, ka bërë shikimin në licencën e datës 05.04.2012, ka bërë shikimin në listën e pagave të datës 01.04.2021, për paditësin e dytë N. B., ka bërë shikimin e kontratës së punës për mësimdhënës të datës 01.09.2018, ka bërë shikimin në vërtetimin për përvojën e punës me nr. 229, të datës 19.07.2021, ka bërë shikimin në diplomën e fakultetit me nr. 1548, të datës 18.10.2017, ka bërë shikimin në licencën e datës 26.09.2019, ka bërë shikimin në listën e pagave të datës 01.04.2021, për paditësin e tretë D. B. ka bërë shikimin e kontratës së punës për mësimdhënës me nr. prot. 105/18, të datës 05.10.2016, ka bërë shikimin në diplomën e fakultetit nr.350, të datës 20.02.2012, ka bërë shikimin në vërtetimin për përvojën e punës me nr. 233, të datës 19.07.2021, ka bërë shikimin në licencën e datës 29.12.2015, ka bërë shikimin në listën e pagave të datës 01.04.2021, si dhe te paditësja e katërt K. S. ka bërë shikimin e kontratës së punës për mësimdhënës me nr. prot. 102/18, të datës 01.10.2016, ka bërë shikimin në diplomën e fakultetit nr. 122, te datës 28.12.2015, ka bërë shikimin në vërtetimin për përvojën e punës me nr. 231, të datës 19.07.2021 ka bërë shikimin në licencën e datës 30.09.2019, ka bërë shikimin në listën e pagave të datës 01.04.2021, si dhe ka bërë shikimin në kërkesës drejtuar DKA-së, të datës 30.09.2021.

Pas analizimit dhe vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, bazuar në dispozitat të neneve 7 dhe 8 të LPK-së, duke i vlerësuar deklaratimet e ndërgjyqësve dhe në bazë të bindjes së vetë të lirë, është konstatuar se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar dhe e njëjta është aprovuar.

Me shikimin e vendimit për caktimin e ushtruesit te detyrës te drejtoritë shkollës të lëshuar nga kryetari i komunës të datës 31.12.2020, për paditësen Sh. Sh., gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se këtu paditësja Sh. Sh. ka qenë e sistemuar në punët dhe detyrat e punës si U.D e drejtoreshës në SHFMU “Dëshmorët e Zatriqit” në Zatriq.

Me shikimin në vërtetimet mbi përvojën punës nr.225, të datës 19.07.2021, të lëshuara nga SHFMU “Dëshmorët e Zatriqit” vërtetohet se paditësja Sh. Sh. ka përvojë të përgjithshme pune mbi 10 vite.

Me shikimin në diplomën e fakultetit për paditësen Sh. Sh. me nr.190, të datës 23.02.2010, vërtetohet se paditësja është e diplomuar në drejtimin Gjuhe dhe Letërsi Shqipe

Me shikimin në vërtetimin e licencës me nr. 100000036, të datës 05.04.2012, vërtetohet se paditësja Sh. Sh. është pajisur me licencë të karrierës, niveli i rregullt.

Me shikimin në listën e pagave vërtetohet se paditësja Sh. Sh. është kompensuar në shumë prej 58.21 €.

Me shikimin në kontratën e punës për mësimdhënësin N. B. të datës 01.09.2018, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se këtu paditësi N. B. ka qenë i sistemuar në punët dhe detyrat e punës si mësimdhënës në SHFMU “Dëshmorët e Zatriqit” në Zatriq.

Me shikimin në vërtetimet mbi përvojën punës nr.229, të datës 19.07.2021, të lëshuara nga SHFMU “Dëshmorët e Zatriqit” vërtetohet se paditësi N. B. ka përvojë të përgjithshme pune mbi 3 vite.

Me shikimin në diplomën e fakultetit për paditësin N. B. nr. 1548, të datës 18.12.2017, vërtetohet se paditësi është i diplomuar në drejtimin Programi Fillor.

Me shikimin në vërtetimin e licencës me nr. 1027403, të datës 26.09.2019, vërtetohet se paditësi N. B. është pajisur me licencë të karrierës, niveli i rregullt.

Me shikimin në listën e pagave vërtetohet se paditësi N. B. është kompensuar në shumë prej 58,32 €.

Me shikimin në kontratën e punës për mësimdhënësin D. B. me nr. prot. 105/2018, të datës 05.10.2016, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se këtu paditësi D. B. ka qenë i sistemuar në punët dhe detyrat e punës si mësimdhënësi në SHFMU “Dëshmorët e Zatriqit” në Zatriq.

Me shikimin në vërtetimet mbi përvojën punës nr.233, të datës 19.07.2021, të lëshuara nga SHFMU “Dëshmorët e Zatriqit” vërtetohet se paditësi D. B. ka përvojë të përgjithshme pune mbi 7 vite.

Me shikimin në diplomën e fakultetit për paditësin D. B. nr. 350, të datës 20.02.2012, vërtetohet se paditësi është i diplomuar në drejtimin Histori – Edukatë Qytetare.

Me shikimin në vërtetimin e licencës me nr. 100023214, të datës 29.12.2015, vërtetohet se paditësi D. B. është pajisur me licencë të karrierës, niveli i rregullt.

Me shikimin në listën e pagave vërtetohet se paditësi D. B. është kompensuar në shumë prej 58,32 €.

Me shikimin në kontratën e punës për mësimdhënësen K. S. me nr. prot. 102/18, të datës 01.10.2016, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se këtu paditësja K. S. ka qenë e sistemuar në punët dhe detyrat e punës si mësimdhënëse në SHFMU “Dëshmorët e Zatriqit” në Zatriq.

Me shikimin në vërtetimet mbi përvojën punës nr.231, të datës 19.07.2021, të lëshuara nga SHFMU “Dëshmorët e Zatriqit” vërtetohet se paditësja K. S. ka përvojë të përgjithshme pune mbi 5 vite.

Me shikimin në diplomën e fakultetit për paditësen K. S. nr. 122, të datës 28.12.2015, vërtetohet se paditësja është e diplomuar në drejtimin Program Fillor.

Me shikimin në vërtetimin e licencës me nr. 1027414, të datës 30.09.2019, vërtetohet se paditësja K. S. është pajisur me licencë të karrierës, niveli i rregullt.

Me shikimin në listën e pagave vërtetohet se paditësja K. S. është kompensuar në shumë prej 53,32 €.

Me shikimin e kërkesës të datës 30.09.2021, drejtuar DKA-së, në Rahovec vërtetohet se këtu paditësit kanë paraqitur kërkesë për kompensim.

Sipas dispozitës së nenit 7 paragrafi 1, pika 3 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e datës 18.04.2017, është paraparë se: *“Me Licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë: Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katërvjeçar, 27 % e pagës.*

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe provave të administruara në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se, kërkesëpadia e paditëses duhet të aprovohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Si përfundim gjykata vlerësoi se kjo e drejtë i takon paditëses në kuptim të dispozitave të lartcekura, për çka dhe vendosi që kërkesëpadinë e paditëses ta aprovoj si të bazuar dhe e detyroi të paditurën që paditëses t'ia paguajë pagat në emër të udhëtimit dhe ushqimit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi kamatën, gjykata e mori në kuptim të nenit 382, të LMD-së.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale, gjykata e mbështeti në harmoni me dispozitat e nenit 452.1 të LPK-së, dhe vendosi që e paditura t'ia kompensoj paditëses shumën prej 619.00€, e që kanë të bëjnë: për përpilimin e padisë shumën prej 260,00 €, për taksën gjyqësore shumën prej 21,00 €, si dhe për përfaqësim në një seancë shumën prej 338,00 €, ndërsa refuzohet për pjesën tjetër në shume prej 472 ,00 €.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC
C.nr.1012/2021, më 20.06.2022

B. Profesionale
Adelina Çmega

Gjyqtari
Betim Behluli

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimi. Ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate, për gjykatën e Apelit në Prishtinë – divizionit civil.